

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora 09:37**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 32 me objekt “Kundërshtimi i vendimit 345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, Qarku Vlorë”, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 subjekti ankues z.Tahsim Mehmeti”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, O.Peto
- **Koalicione:** Tasim Mehmeti (ABEOK)

**Z. L. Braho:** Mirëmëngjesi! Çelim seancën për shqyrtimin e verifikimit të formës dhe të elementeve të parashikuar në nenin 130, për kërkesën ankimore me nr. 32, ndaj vendimmarrjes së KQZ-së për Qarkun e Vlorës, në zbatim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, ku ka paraqitur ankim zoti Tahsim Mehmeti, kandidat për deputet i listës shumemërore të subjektit zgjedhor, koalicioni ABEOK, për Qarkun Vlorë, i cili në respektim të kriterëve të zbatuara në nenin 127, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 32, datë 11.05.2021. Në zbatim të nenit 12 të Rregullores për funksionimin dhe zhvillimin e seancave të KAS-it, datë

1

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

10.05.2021, është hedhur shorti për të përcaktuar relatorin e seancës së kësaj kërkesë ankimore, nga ku u caktua si relator anëtari i KAS, Ledio Braho.

Ka ndonjë pretendim në lidhje me anëtarët e KAS-it për konflikt interesi, nga anëtarët vetë ose nga pala ankimuese.

**Z.T. Mehmeti:** S'kam gjë! Jam korrekt.


**Z. L. Braho:** Atëherë seanca e sotme është seancë për verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës dhe zhvillohet në zbatim të neneve 17 dhe 18 të Rregullores së KAS-it dhe në zbatim të nenit 129 të Kodit Zgjedhor, ku verifikohen elementët e parashikuara në nenin 126 dhe 130 të tij.

Atëherë ju jeni zoti Tahsim Mehmeti?!

**Z. T. Mehmeti:** Po!

**Z. L. Braho:** Keni paraqitur një kërkesë ankimore që unë e citova dhe, një sqarim në lidhje me emrin e subjektit zgjedhor që ankimohej, dhe referimin e vendimit që ankimohej sepse nuk kishte gjë të cituar. Dhe nga kërkesa ankimore pamë që ishte nënshkruar nga ju, si kandidat i listës shumëmemërore, dhe nga kryetari i Partisë për Emigracionin Shqiptar. Për ne, është e paqartë se kush është subjekti dhe pa zgjidhur këtë, bazuar në nenin 126, nuk marrim dot një vendim. Kështu që, ju lutemi na sqaroni në lidhje me këto elemente!

**Z. T. Mehmeti:** Tani unë iu bashkëngjita këtij koalicioni, mbasi këta të katërt si deputetë që janë në parlamentin shqiptar sot respektuan demokracinë dhe sistemin demokratik duke respektuar listën dhe vendimin që mori kuvendi, dhe duke qenë



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

njerëz dhe deputetë të tillë me vizion largpamës që i shërbejnë demokracisë, kombit dhe shumë gjërave të tjera për mirë. Unë iu bashkëngjita këtij koalicioni mbasi edhe unë kam bërë një gjyq, ... isha me "Sfidën", por ajo nuk kandidoi këtë radhë, ... punë e saj..., kështu që arsyet e mija këtu janë këto: iu bashkëngjita këtij koalicioni pasi demokracia është votë dhe është respektim i institucioneve. Jo se unë jam futur në këtë punë, ose dhe në këtë! ..., për të dhënë një mesazh politikës shqiptare, institucioneve të këtij vendi, shtetit shqiptar, KQZ-së, prokurorisë e shumë e shumë institucioneve, kështu që, për të gjithë ka një fillim, ka dhe një fund. Dhe është momenti, duke dëgjuar se si lëvizin gjërat, qoftë nga politika, qoftë nga ndërkombëtarët, se çfarë mesazhesh përcjellin; tani unë me Kostaq Papën, Kryetarin e Partisë së Emigracionit Shqiptar, e gjeta veten këtu, pasi duke qenë një kryetar partie, në zonën ku unë kam jetuar që nga 1956-ta deri në 2000-në, pasi në 2001-in kam ardhur në Tiranë, dhe te ky zotëri kisha shumë gjëra që më bashkonin, duke qenë dhe nga pjesa e Vlorës, duke pasur mamanë vlonjate, babanë nga Çamëria, gjyshi ka ardhur në 1920-ën dhe ka luftuar në batalionin e Vlorës. Kështu që unë nuk jam rastësi në politikë! Është zoti, vullneti im edhe miqtë e mi të politikës, që një zë për Çamërinë e vërtetë të ngrihet në Parlamentin Shqiptar.

**Z. L. Braho:** Zoti Mehmeti, pa pasur vullnetin për t'ju ndërprerë, në seancën e sotme, thashë, është vetëm për elementët e formës, dhe nga ju do të doja të sqarohesha se kush quhet subjekti zgjedhor që ankimon dhe, kush është vendimi përkatës që ankimoni?! Keni ndonjë të dhënë për vendimin që ankimoni?!

**Z. T. Mehmeti:** Më fal! Keni shumë të drejtë! Problemi është ky unë shikoja që afati po kalonte, ditët për të ankimuar po mblidheshin! Katër ditë kam ardhur këtu dhe i kam bezdisur ndoshta protokollin, por rruga që ky koalicion, ndoshta nuk



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

ishin shumë unik në marrjen e një vendimi. Ndërsa unë gjeta tek Kostaq Papa, pra gjeta mbështetje, të cilën ia mora, siç edhe e ke parë me firmë me vulë dhe me të gjitha, sepse unë përfaqësoj Partinë e Emigracionit Shqiptar. Nuk e di nëse të sqarova!

**Z. L. Braho:** E kuptoj! Një pyetje për Administratën e KQZ-së, sipas aktmarrëveshjes që ka depozituar KQZ nga koalicioni ABEOK, kush ka tagra për përfaqësimin e këtij koalicioni në KQZ?

**Z. Y.Merkaj:** Partia Konservatore Albania është udhëheqëse e koalicionit, me kryetar Kujtim Gjuzi.

**Z. L. Braho:** Besoj e dëgjuat përgjigjen e Administratës së KQZ-së.

**Z. T. Mehmeti:** Absolutisht! e dëgjova, vendimet i merrni ju unë që erdha deri këtu, e mbylla detyrën time në një moment të dytë ndoshta do të shihemi prapë.

**Z. L. Braho:** Shumë faleminderit që e vlerësoni KAS-in, ne do të tërhiqemi për vendim në lidhje me këtë kërkesë, për këtë fazë që jemi, dhe do tua komunikojmë për pesë minuta! Faleminderit! ... të dal jashtë unë?!

**Z. L. Braho:** Po, pesë minuta!

**Z. T. Mehmeti:** Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 09:44**

**Z. L. Braho:** Zoti Mehmeti, si fillim dua t'ju sqaroj që koalicioni ABEOK, pas kërkesës që ju keni depozituar në KQZ, ka sjellë dhe kërkesa të tjera ankimore, në lidhje me vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe janë nënshkruar nga tre përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, pra edhe nga zoti Kujtim Gjuzi. Kjo është për të dhënë dijeninë që ata e kanë vullnetin për të bërë ankim!

Ndërkohë, që ne, patjetër jemi të gatshëm që ti japim zgjidhje çdo lloj mosmarrëveshje dhe çdo lloj pretendimi që palët kanë në lidhje me këtë proces;

Në bazë të neneve 21 pika 1, shkronja b, 126 dhe 129, pika 1 dhe pika 3, shkronja c, të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 17 pika 2 dhe pika 3, shkronja c të vendimit të KRR-së, për mënyrën e funksionimit të KAS-it, vendosëm:

Kthimin e Kërkesës Ankimore nr. 32, datë 07 Maj 2021, për plotësim të elementëve të formës, të përcaktuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, të paraqitur nga zoti Tahsim Mehmeti, kandidat për deputet nga lista shumë emërore të koalicionit ABEOK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në kolegjin zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Tani për tu sqaruar sipas kodit zgjedhor keni një afat 24 orë, për të plotësuar ato elementë të formës, pra e para, subjektin ankimues, nëse do të keni mundësinë që të merrni firmat nga përfaqësuesit e koalicionit, dhe e dyta të sillni edhe vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilin ju ankimoni, sepse ishte i paqartë në kërkesën ankimore. Në momentin që ju plotësoni këto dy elemente, atëherë brenda afatit 24 orë, ne, mund të shprehemi në lidhje me vijimin e kësaj procedure.

5

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Faleminderit!

**Z. T. Mehmeti:** Faleminderit! Do ma japin vendimin apo jo?! Vendimin që, ... më fal se ndoshta, ... s' dua t'ju bezdis, .. mirë! Dakord, dakord vëlla! Faleminderit!  
Jo më fal, desha të sqaroja këtë! Kërkoj falje! Unë nga Kostaqi e kam firmosur!  
Duhet edhe nga Zef Shtjefni firma! ... dhe nga Kujtim Gjuzi?!

**Z. I. Rusmali:** Ose nga përfaqësuesi i këtyre ose dhe nga kandidatët!  
Faleminderit! Punë të mbarë!

**Z. Y. Merkaçaj:** Zakonisht në veprimet paraprake nuk marrin pjesë përfaqësuesit e partive! E kanë si praktikë pune!

**Vendimi nr.56**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

11.05.2021  
Ora 09:37

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 33 me objekt “Kundërshtimi i vendimit 347, datë 04,05,2021 të KSHZ “Për Miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, qarku Gjirokastrë”, subjekti ankues LSI”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**
- **Koalicione:** Tasim Mehmeti (ABEOK)

**Z. L. Braho:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 347, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25 Prill 2021, në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe 123 të Kodit Zgjedhor, ka vendosur miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore, Qarku Gjirokastrë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dale nga zgjedhjet e datës 25 Prill 2021. Në tabelë janë bashkëlidhur edhe anekset me rezultatet përkatëse për çdo subjekt zgjedhor, dhe në zbatim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia LSI, e cila në zbatim të kriterëve të

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*


neneve 127 të Kodit Zgjedhor është regjistruar në regjistrin e ankimeve me nr. 33, në datën 7 Maj 2021. Në zbatim të nenit 12 të rregullores së funksionimit të KAS-it, është hedhur shorti. Shorti ka përcaktuar si relator anëtarin e KAS-it, zotin Ledio Braho. Ka ndonjë pretendim nga anëtarët e KAS-it, për konflikt interesi, meqenëse subjekti nuk ndodhet në sallë? Seanca e sotme është seancë për verifikimin e ekzistencës së elementëve të formës dhe të verifikimit paraprak dhe zhvillohet në zbatim të neneve 17 dhe 18 të rregullores së KAS-it dhe në zbatim të nenit 129 të Kodit Zgjedhor, ku verifikohen elementët e parashikuar në nenin 126 dhe 130 të tij. Një pyetje për administratën e KQZ-së, kjo në lidhje me elementët e formës të përcaktuara në nenin 126-të. A është e rregullt kërkesa e paraqitur nga subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim?!

**Z. Y. Merkaç:** Po është në përputhje dhe ka të paraqitur emrin, mbiemrin bazën ligjore, përshkrim të shkurtër të shkeljes si dhe ka treguar prova për pretendimet e tyre!

**Z. L. Braho:** Po në zbatim të nenin 130 që përcakton kompetencën e KAS-it, mbi legjitimitetin e ankuesit për respektimin e afateve ligjore?

**Z. Y. Merkaç:** Kërkesa ankimore është brenda afatit të përcaktuar në ligj, pasi ankimon vendimin e KSHZ, të datës 04.05.2021, kërkesa është brenda afatit sepse është paraqitur në datën 05.04.2021, i drejtohet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve, gjithashtu subjektit LSI i janë cenuar të drejtat sipas tyre gjatë miratimit të tabelave të zgjedhjeve të datës 25 prill, kështu që plotëson edhe elementin e legjitimitetit të ankuesit.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. L. Braho:** Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në zbatim të neneve 126, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, pas relatimit të çështjes dhe pas sqarimit të dhëna nga ana e administratës së KQZ-së, vendosi kalimin e ankesës ankimore nr. 33 të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim për shqyrtim. Seanca për shqyrtimin e kërkesës ankimore do të mbahet në datë 12 maj 2021, në orën 09:30. E deklarojmë të mbyllur këtë seancë!

**Vendimi nr.57**

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

11.05.2021  
Ora 09:55

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 34 me objekt “1- Ndryshimi i vendimit 339, datë 04,05,2021 të KSHZ "Për Miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, qarku Berat", 2- Rinumërimi dhe rivlerësimin e votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66,67 dhe 68”, subjekti ankues LSI”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

*Z. E. Çefa:* Vazhdojmë me kërkesën tjetër ankimore! Atëherë hapim seancën për verifikimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 34, datë 09.05.2021, e paraqitur nga subjekti ankimues Lëvizja Socialiste për Integrim. Objekt i ankimit është ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 339 datë 04.05.2021, Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe qendrat e votimit listuar në tabelën bashkëlidhur ankimit, dhe miratimi i tabelës përmbledhëse Qarku Berat duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për qendrat e listuara në ankim.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Relator i kësaj kërkesë ankimore sipas shortit të hedhur ditën e djeshme jam unë Elvis Çefa, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk kanë deklaruar asnjë deklaram për konflikt interesi; mund të procedojmë me verifikimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes të cilat unë i konstatoj që janë të plotë dhe i gjej të rregullta; po ashtu kërkesa ankimore plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 130 t5e Kodit Zgjedhor, KAS-i është kompetent për shqyrtimin e këtij ankimi. Subjekti ankimues ka legjitimitet për shkak se i është cënuar sipas tyre interesi i ligjshëm dhe ankimi është bërë brenda afatit të përcaktuar në Kod. Në këtë kontekst propozoj kalimin për shqyrtim të këtij ankimi dhe caktimin e datës së seancës së themelit, nesër datë 12.05.2021, ora 10:30. Faleminderit! Atëherë seancën e deklaroj të mbyllur!

**Vendimi nr.58**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora 09:58**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 35 me objekt “1- Kundërshtimi i vendimit 339, datë 04,05,2021 të KSHZ "Për Miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, qarku Berat"; 2- Shpalljen e pavlefshme të procesit të votimit në qendrat e votimit të qarkut Berat si dhe përsëritjen e zgjedhjeve”, subjekti ankues LSI”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. K. Bele:** Çelim seancën për shqyrtimin publik dhe shqyrtimin e ankimit dhe verifikimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes, të ankimit nr. 35, të subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim; objekti është kundërshtimi i vendimit nr. 339/6, date 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e tabelës përmbledhëse për miratimin e rezultatit të votimit të Qarkut Berat; dhe pika e dytë, shpallja e pavlefshmërisë së procesit të votimit për qendrat e votimit të qarkut Berat, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Sipas shortit të hedhur në përputhje me procedurën, relator i saj jam unë, Koli Bele.

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Nga verifikimi paraprak, duke qenë se në vijim të procedimeve të mëparshme, nuk verifikohen elementë që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit nga ndonjë nga anëtarët e KAS-it, Nga verifikimi i kryer për elementët e formës dhe përmbajtjes të këtij ankimi rezultojnë të jenë konform me nenin 124 dhe vijues të kodit. Në këtë kuptim duke analizuar sa më sipër, propozoj kalimin e çështjes për shqyrtim. Duke konstatuar se në vendimin eventual të pranimit të kësaj çështje nga KAS do të kemi dhe element të bashkimit në kuotim të nenit 132 të kodit. Pasi bëhet fjalë për kërkesa ankimore që kanë të bëjnë me një zonë zgjedhore. Në këtë rast Qarku Berat. Pra, KAS i konsultuar në vend, vendosi: Kalimin e çështjes për shqyrtim.

**Vendimi nr.59**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 36, Kundërshtim i vendimit nr. 345, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, subjekti ankues PD.”

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti Politike** L. Nuraj, I. Kaso

**Z. E.Lako:** Atëherë, çelim sot seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve “Për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së ankimit nr. 36, të subjektit ankues Partia Demokratike”. Me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021.” Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën e Qarkut Vlorë. Si edhe urdhërimin për përsëritje të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Vlorë në periudhën më të afërt zgjedhore. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 09.05.2021 bazuar në nenin 129 të Kodit



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Zgjedhor. Të pranishëm në seanc janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm dhe Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu, është i pranishëm dhe përfaqësuesi i subjektit ankues. Para se të fillojmë ftojmë Sekretarin e Përgjithshëm për të bërë një paraqitje të shkurtër të rrethanave të çështjes.

**Z. Y.Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 345, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike e Shqipërisë duke pretenduar se vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës së rezultateve është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet të ndryshohet. Në këto kushte ka paraqitur kërkesën ankimore në datën 09.05.2021 në orën 13:40. Për këtë kërkesë ankimore është hedhur shorti dhe është caktuar relatori. Është vendosur sot seanca paraparake për të verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike.

**Z. E.Lako:** Ankuesi nëse dëshironë për të shtuar diçka në lidhje me.. nuk ka. Atëherë, anëtarët e KAS-it kanë ndonjë pyetje?

**Z. L.Braho:** Kisha një sqarim në lidhje me ankimin. Sepse në ankim shkruhet që ankimues është Partia Demokratike. Është Koalicioni PD-AN dhe Partia Demokratike në cilësinë e udhëheqësit të Koalicionit? Pra, kë do të konsiderojmë si ankimues në lidhje me legjimitetin?

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Sigurisht, faleminderit për pyetjen. Në bazë të marrëveshjes të Koalicinit të depozituar partia udhëheqëse e Koalicionit që ka



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

tagrat edhe për të zhvilluar proces ankimor dhe për procedura të tjera para Komisionot Qendror të Zgjedhjeve është Partia Demokratike e Shqipërisë. Për çështje praktike dhe veçnisht për çështjen e vulosjes së ankimit është menduar që të jetë Partia Demokratike e Shqipërisë. Sigurisht në cilësin, pasi ajo nuk ka garuar dhe vetë si subjekt zgjedhor por ka garuar në kuadër të Koalicionit Aleanca Për Ndryshim me cilësin e partisë udhëheqëse të Koalicionit. Kështu që sigurisht në këtë cilësi është edhe në pozicionin e ankueses përpara jush. Si Partia Demokratike, partia udhëheqëse e Koalicionit PD-AN. Tagrat nuk janë sqaruar në kërkesën ankimore për shkak se marrveshja e Koalicionit i përmban të qarta. Por, nëse është e nevojshme që edhe këtë parashtim ta depozitojmë me shkrim. Pra, nëse ju e shikoni me vend mund ta bëjmë edhe këtë lloj sqarimi.

*(nuk dëgjohet)*

**Z. L.Braho:** Mjafton sqarimi dhe ne si ankues do konsiderojmë Koalicionin PD-AN. Dakord, nuk kemi gjë tjetër.

**Z. E.Lako:** Faleminderit, nëse nuk ka pyetje të tjera KAS tërhiqet për vendim.

**Rifillon seanca**

**Ora 10:12**

**Z. E.Lako:** Atëherë, pasi dëgjuam me vëmendje dhe morëm parasysh pretendimet e palëve, bazën ligjore dhe provat e dokumentuara. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosi:

1. Bazuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor kërkesa ankimore paraqitur nga Partia Demokratike në emër të Koalicionit PD-AN i përmbush elementët e formës. Pra, plotësohen kërkesat e nenit 129 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

2.Gjithashtu, plotësohen kërkesat e nenit 130 të Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë konkretisht me kompetencën e KAS-it për të shqyrtuar ankimin, legjitimin me ankuesit dhe afati brenda të cilëve është bërë ankimi.

Në këto kushte Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosi:


1.Kalimin e ankimit për shqyrtim.

2.Seanca për shqyrtim do të jetë në datën 12.05.2021, ora 11:30.

*(diskutime ndërmejt anëtarëve të KAS) Faleminderit.*

**Vendimi nr. 60**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



11.05.2021  
Ora 10:14

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 37,  
Kundërshtim i vendimit nr. 340, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën  
zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për  
deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”,  
subjekti ankues PD.”

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti Politike** L. Nuraj, I. Kaso

**Z. K.Bele:** Vazhdojmë me seancën publike të KAS për të verifikuar elementët, plotësimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes të ankimit nr. 37, të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë. Me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 340, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse në zonën e Qarkut Durrës.” Relatori siç është lajmëruar jam zgjidhur unë, Koli Bele, sipas shorti të hedhur në datën 09.05.2021. Të pranishëm janë anëtarët e KAS-it si edhe Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të pranishëm janë edhe përfaqësues të subjektit ankues Partia Demokratike. Dukeqenëse rrethanat e ankimit janë identike besoj se Kryetari shprehet vetëm për faktin nëse jemi para plotësimit të elementëve formale..



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y.Merkaj:** Atëherë, nga ankimi nr. 37 plotësohen elementët e ankimit sipas nenit 126 i Kodit Zgjedhor. Pasi është plotësuar emri i kodit të subjektit, referimi i vendimit që ankimohet, baza ligjore. Kanë bërë përshkrim të shkurtër të shkëljes. Përshkrim i fakteve dhe argumentave. Ka treguar prova të cilat kërkon të marrë gjatë gjykimit. Si edhe datën dhe firmën e ankimuesit. Gjithashtu plotësori dhe neni 130 të Kodit Zgjedhor pasi legjitimohet dekreti i këtij ankimi. Ankimi është bërë brenda afatit të përcatuar nga ligji dhe është kompetent. I është drejtuar KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e ankimit të Komisionerit, faleminderit.

**Z. K.Bebe:** Dakord, nëse nuk ka ndonjë pyetje apo diçka nga anëtarët e KAS-it apo nga pala prezante në shqyrtim. KAS i konsultuar në vend, vendos. Duke konstatuar besoj në të njëjtën mënyrë si edhe të ankimit paraardhës që Partia Demokratike ka ushtruar të drejtën e saj si drejtuese e Koalicionit. Por, për efekt formal subjekti ankues do të konsiderohet Koalicioni. I cili ka administruar rezultatin përkatës të zonës zgjedhore. Është pala në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe në këto kushte KAS i konsultuar në vend, vendosi:

1.Kalimin për shqyrtimin e kësaj çështje në seancën publike dhe orari do të jetë dita e nesërme, datë 12.05.2021, ora 12:30.

Nga seanca saktësojmë orarin. Do të vendoset nesër në orën 12:00.

**Vendimi nr. 61**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 38, Kundërshtim i vendimit nr. 342, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, subjekti ankues PD.”

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti Politike** L. Nuraj, I. Kaso

**Z. E.Lako:** Atëherë, çelim seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve “Për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes së ankimit numër 38, të subjektit ankues Partia Demokratike në emër të Koalicionit PD-AN. Me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 342, datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Shkodër për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.” Pavlefshmëria e zgjedhjeve e zhvilluara në datën 25 Prill 2021 i zonës zgjedhore Qarku Shkodër. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonat e Qarkut Shkodër në periudhën më të afërt zgjedhore. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako sipas shortit të hedhur në datën 09.05.2021 mbështetur në nenin 129 të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në senacë janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, Sekretari i Përgjithshëm edhe Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu është i pranishëm dhe përfaqësues i subjektit ankues. Shkurtimisht nga Sekretari i Përgjithshëm dy fjalë për plotësimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes së ankimit.

**Z. Y.Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr. 342, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Kundër këtij vendimi duke mos qenë dakord ka bërë ankim Partia Demokratike në datën 09.05.2021, brenda afatit ligjor. Duke parashtruar që është në kundërshtim me miratimin e kësaj table dhe ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datë 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Si edhe kërkon urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Referur nenit 126 të Kodit Zgjedhor ankimi plotëson elementët formal të elementeve të formës si, është përcaktuar emri, mbimeri i subjektit ankues, adresa e tij. Ka referuar dhe vendimin që ankimon. Ka përcaktuar bazën ligjore. Ka përshkruar shkeljen e pretenduar. Ka përshkruar dhe fakte dhe argumente të dispozitave të cilat mbështetet ankimi. Gjithashtu tregon dhe provat në të cilat kërkon të meret gjatë procesit të shqyrtimit. Është data dhe frima e ankuesit. Gjithashtu referuar nenit 130 të Kodit Zgjedhor është respektuar afati ligjor i ankimit. Legjitimohet nëpërmejt kësaj kërkesës ankimore. Gjithashtu i është drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve si organi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. E.Lako:** Faleminderit, subjekti ankues ndonjëgjë? Jo. Dikush nga anëtarët? Jo. Atëherë, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve tërhiqet për të marrë vendim. I

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

konsultuar në vend pasi dëgjojë me vëmendje dhe mori parasysh bazën ligjore dhe provat e dokumentuara Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosi:

1.Ta kalojë këtë çështje për shqyrtim.

2.Seanca e rradhës do të jetë në datë 12.05.2021 ora 12:30.

Faleminderit!

**Vendimi nr. 62**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



**11.05.2021  
Ora 10:22**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 39,  
Kundërshtim i vendimit nr. 343, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën  
zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për  
deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”,  
subjekti ankues PD.”*


**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti Politike** L. Nuraj, I. Kaso

**Z. L.Braho:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 343 datë 04.05.2021 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë”. Në mbështetje të neneve 19 dhe 123 të Kodit Zgjedhor ka vendosur miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputetë për këtë zonë zgjedhore. Ndaj kësaj vendimmarrje ka depozituar ankim Partia Demokratike e Shqipërisë. Ku siç u cilësua dhe më herët nga përfaqësuesi i saj në lidhje me ankimet e tjera këto ankime janë bërë nga Partia Demokratike e Shqipërisë në cilësinë e udhëheqësit të Koalicionit Partia Demokratike Aleanca Për Ndryshim. Objekt i ankimit është kundërshtimi i vendimit nr. 343 i datës 04.05.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën

1

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

zgjedhore Qarku Tiranë. Si edhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë në periudhën më të afërt zgjedhore. Seanca e sotme zhvillohet për verifikimin e elementëve formal të kërkesës ankimore dhe të përmbajtjes nga Administrata zgjedhore nëse kjo kërkesë ankimore është në përputhje me nenet 126, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor?

**Z. Y.Merkaj:** Po, kërkesa ankimore plotëson elementët e parashikuar në nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Pasi është përcaktuar emri i ankuesit është referuar vendimi në kohën ankimore. Ka vendosur bazën ligjore. Është përshkruar shkelja e pretenduar. Janë përshkruar faktet dhe argumentat tek të cilat mbështetet ankimi. Gjithashtu tregon dhe provat të cilat kërkon të marren gjatë procesit të ankimimit dhe është caktuar data dhe firma e ankimuesit. Gjithashtu është paraqitur kërkesa brenda afatit të përcaktuar nga ligji 5 ditorë për ankimin tek Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Legjitimohet në ngritje të kësaj kërkesë pasi çënohen të drejtat legjitime të subjektit zgjedhor dhe i është drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve si organi kompetentë për shqyrtimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. L.Braho:** Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm. Atëherë, KAS i konsultuar në vend dhe pas relatimit të administratës së KQZ-së në zbatim të nenit 129 pika 3 shkroja “a”, vendosi:

- 1.Kalimin e kërkesës ankimore nr. 39 të depozituar në datë 09.05.2021 për shqyrtim.
- 2.Seanca për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore nga KAS caktohet në datë 12.05.2021 në orën 13:00.

Deklaroj senacën të mbyllur.

**Vendimi nr. 63**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





**11.05.2021  
Ora 10:25**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 40,  
Kundërshtim i vendimit nr. 344, dt. 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën  
zgjedhore Qarku Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për  
deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”,  
subjekti ankues PD.”*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,  
Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O. Peto
- **Parti Politike** L. Nuraj, I. Kaso

*Z. E.Lako:* Atëherë, çelim senacën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së ankimit nr. 40 të subjektit ankues Partia Demokratike në emër të Koalicionit PD-AN. Në objekt kundërshtimin e vendimit nr. 344, datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Elbasan për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Si edhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Elbasan në periudhën më të afërt zgjedhore. Të pranishëm në senacë janë anëtarët e KAS-it, Sekretari i Përgjithshëm, Administrata e KQZ-së dhe

1

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SADILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

përfaqësues i subjektit ankues. Shkurtimeisht për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes nga Sekretari i Përgjithshëm.

**Z. Y.Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr. 344, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Kundër këtij vendimi duke mos qenë dakord ka bërë ankim subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë në datën 09.05.2021. Duke kërkuar kundërshtimin e tabelës përmbledhëse e rezultatit për Qarkun Elbasan. Gjithashtu kërkon pavlefshëmrin e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Si edhe kërkon urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Elbasan në periudhën më të afërt zgjedhore. Kërkesa ankimore e paraqitur nga Partia Demokratike plotëson kërkesat e nenit 126 të Kodit Zgjedhor. Pasi përmban emrin e plot të subjektit dhe adresën e tij. Referon vendimin ku ankimohet. Përmban bazën ligjore ku është mbështetur ankimi. Gjithashtu përmban përshkrimin e shkrutër të shkeljes ë pretenduar. Përmban përshkrimin e fakteve, argumentave, dispozitata ligjore tek të cilat mbështetet ankimi. Ka treguar provat të cilat këkron të merren gjatë shqyrtimit administrativ. Ka caktuar datën dhe firmën e ankimuesit. Gjithashtu dhe elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor. Pasi ka respektuar afatin ligjor të ankimit është brenda afatit ligjor. Legjitimohet në lidhjet e kësaj kërkesë dhe i është drejtuar KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. E.Lako:** Faleminderit! Meqenëse përfaqësuesit e subjektit nuk dëshiron të thotë dicka as nga anëtarët e KAS nuk ka ndonjë pyetje. KAS tërhiqet për të marrë vendim. I konsultuar në vend pasi dëgjojë dhe mori parasysh pretendimet e palëve

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

dhe bazën ligjore dhe provat e dokumentuara Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosi:

- 1.Ta kalojë këtë çështje për shqyrtim.
- 2.Seanca e radhës do të jetë në datën 12.05.2021 ora 13:30.  
Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 64**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 41 objekti "Kundërshtimi i vendimit nr.347, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit ankues PD".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:** I.Kaso, L.Nuraj

**Z. K. Bele:** Atëherë, vazhdojmë me seancën publike të KAS për të verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes të ankimit numër 41. Të subjektit ankues Partia Demokratike si përfaqësues i koalicionit PD AN me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit numër 347, datë 04.05.2021, për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Relatori i seancës jam unë Koli Bele sipas shortit të datës 9, të pranishëm anëtarët, administrata dhe përfaqësuesi i subjektit ankues. Nga verifikimi rezulton që elementët e formës dhe të përmbajtjes janë në përputhje me nenet 126 e vijues të Kodit, ky qëndrim Sekretari i Përgjithshëm konfirmohet?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Po, i plotëson elementët dhe përmbajtjen 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

**Z. K. Bele:** Faleminderit, nëse ska ndonjë pyetje apo ndërhyrje nga përfaqësuesit, KAS i tërhequr, i konsultuar në vend vendos për kalimin e kësaj çështje në shqyrtim. Duke konstatuar gjithashtu se kjo çështje në kuptim të nenit 132 neni para rastit të bashkimit, më një çështje me një ankim po për këtë qark i cili është regjistruar më parë si subjekti zgjedhor LSI. Ankimi është numër 33 dhe kjo çështje ka relator zotin Ledio Braho. KAS i konsultuar në vend vendos bashkimin e këtyre çështjeve dhe vazhdimin e shqyrtimit si një çështje e vetme me numër 33.

**Z. Y. Merkaj:** Më fal, një saktësim nuk është zoti Ledio Braho por zoti Elvis Çefa relatori i kërkesës ankimore numër 33.

**Z. K. Bele:** Ska gjë se numëra shumë edhe ngatërrohen rëndësi ka të mos humbasim fokusin te themeli këto janë gjëra që do ti rregullojmë. Pra, kjo bashkë me ankimin e Partisë Socialiste, do të fillojë shqyrtimin nesër në orën 09:30, faleminderit.

**Vendimi nr.65**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



**11.05.2021  
Ora10:31**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 42 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.339, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet  
në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit  
ankues PD".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:** I.Kaso, L.Nuraj, M. Logu

**Z. I. Rusmali:** Mirë, çelim seancën paraprake për kërkesën ankimore numër 42. Kërkesa ankimore është paraqitur nga Partia Demokratike, ka për objekt kundërshtimin e vendimit numër 339, datë 04.05.2021, për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore të Qarkut Berat. Kërkon pavlefshmëri në zgjedhje të qëndruar në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Berat dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të gjithë zonës zgjedhore të këtij qarku në periudhën më të afërt zgjedhore. Në shqyrtimin në këtë seancë përgatitore janë prezent përfaqësuesit e subjektit zgjedhor dhe Sekretari i Përgjithshëm me stafin e administratës. Ka ndonjë kërkesë në raport me anëtarët e KAS-it nga ana juaj? Anëtarët e KAS-it, ka ndonjë kërkesë deklarimi për të bërë në lidhje me konflikt interesi? Nuk ka, mirë Sekretari



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

i Përgjithshëm nga shqyrtimi paraprak i juaj çfarë rezulton në raport me elementët e formës?!

**Z. Y. Merkaç:** Nga shqyrtimet paraprake dhe verifikimi i kërkesave ankimore rezulton, se plotëson kërkesat e parashikara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenin 130, pasi përmban elementët emrin e plotë të subjektit dhe e vendimit ku ankimohej, përshkruan bazën ligjore, përshkrimi shkurt i shkeljes së pretenduar, përmban përshkrimin e fakteve, argumenteve tek të cilat mbështetet ankimi dhe përmban provat të cilat kërkon të marri gjatë shqyrtimit administrativ është caktuar data dhe firma ankimuesit. Gjithashtu në referencën 130 të Kodit Zgjedhor, ka respektuar afatin ligjor të ankimit ëshë parashikuar brenda afatit ligjor dhe gjithashtu në ngritjen e kësaj kërkesë dhe i është drejtuar KAS-it i cili është organi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit përfaqësuesi i subjektit zgjedhor besoj nuk ka ndonjë kundërshtim për këto element? Konfirmon edhe në këtë seancë përgatitore faktin që kërkesa bëhet në emër të subjektit zgjedhor koalicionit dhe jo në emër të vetë subjektit zgjedhor Partia Demokratike por në emër të së drejtës për të përfaqësuar koalicionit si subjekt zgjedhor. Kolegët nuk kanë gjë për të thënë, vazhdojmë siç kemi proceduar deri tani vendosim pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore, për shkak se kjo ka lidhje me një vendim i cili është trajtuar më përpara. Për Qarkun e Beratit dhe për të cilin ky komision ka caktuar relator zotin Elvis Çefa. KAS vendos bashkimin e shqyrtimit të kësaj çështje me kërkesën ankimore nr.34 dhe numër 35 dhe do të shqyrtohet nesër, me datë 12 Maj në orën 12:30, nën drejtimin e relatorit Elvis Çefa e mbyllim këtu këtë seancë.

**Vendimi nr. 66**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora10:35**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 43 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet  
në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit  
ankues PD".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:** I.Kaso, L.Nuraj, M. Logu

**Z. E. Çefa:** Viojmë seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore numër 43, datë 09.05.2021, paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë në emër të subjektit zgjedhor koalicioni PD AN me objekt kundërshtimin e vendimit numër 346 datë 04.05.2021 për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Korçë. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Qarkun Korçë. Sipas shortit të hedhur ditën e djeshme, relatori i kësaj kërkesa jam unë Elvis Çefa. Duke qenë se nga anëtarët e KAS-it nuk ka ndonjë deklaram për konflikt interesi, pyesim përfaqësuesin e subjektit nëse ka diçka për trupin gjykues nëse jo? Atëherë viojmë me vlerësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes. Sekretari i përgjithshëm besoj që kërkesa i plotëson kriteret?

**Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Po, të dy kriteret e nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

**Z. E. Çefa:** Atëherë në këto kushte nuk na mbetet gjë tjetër veç se ti propozoj KAS-it kalimin për shqyrtimin në seancë të kësaj kërkesë, seancë e cila vlerësohet të lihet paraprakisht nesër, në datën 12 Maj, në orën 14:00. Faleminderit seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 67**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



**11.05.2021  
Ora10:37**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 44 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.348, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet  
në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit  
ankues PD".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:** I.Kaso, L.Nuraj, M. Logu

**Z. I. Rusmali:** Mirë, atëherë çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore numër 44, paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë me datë 09.05.2021 dhe që ka për objekt kundërshtimin e vendimit numër 348 datë 04.05.2021. Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Fier dhe kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021. Në këtë zonë zgjedhore dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në periudhën më të afërt zgjedhore. Prezent në këtë seancë shqyrtimi është një nga përfaqësuesit e subjektit zgjedhor pra Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i tij nga administrata e KQZ. Kërkesa paraprake drejtuar nuk ka. Anëtarët për deklaram për konflikt interesi nuk kanë. Vlerësimi paraprak që ka bërë KQZ?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi paraprak konstatohet se ankimi numër 44, plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes të parashikuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, si dhe elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor kështu që kërkesa propozohet të kalojë në shqyrtim.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, koment nga kolegët për këtë jo? Subjekti edhe në këtë rast përsërit saktësinë dhe sqarimin. Kërkesa vjen në emër të subjektit zgjedhor, Koalicionit PD-AN. Kjo është e qartë në të gjitha rastet e paraqitura kështu që KAS vendos kalimin për shqyrtim nesër, me datë 12 Maj, në orën 14:30 faleminderit.

**Vendimi nr.68**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



**11.05.2021  
Ora10:39**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.45 objekti:  
kërkon detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t’u pajisur me  
vendimin e tij për votimin nga jashtë shtetit të qytetarëve të Republikës së  
Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të  
subjektit ankues Koalicioni ABEOK”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:** I.Kaso, L.Nuraj, M. Logu

**Z. I. Rusmali:** Për kërkesën ankimore numër 45, duhet të presim, duhet të jetë  
prezent përfaqësuesi. Do të shikojmë ato të tjerat që janë pa probleme.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora 11:46**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.45 objekti:  
kërkon detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'u pajisur me  
vendimin e tij për votimin nga jashtë shtetit të qytetarëve të Republikës së  
Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të  
subjektit ankues Koalicioni ABEOK".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**
- **Koalicione:** ABEOK

**Z. I. Rusmali:** Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin të Kërkesës Ankimore nr.45 të Koalicionit ABEOK. Prezent në këtë seancë janë përfaqësuesit e Koalicionit. Me mikrofon të lutem.

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK:** Kujtim Gjuzi dhe deputeti, kolegu Jehnihsheri i asistuar nga kryetarja jonë e degës Tropojë, zonja Sanie Hajdarmehtaj.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit, prezent gjithashtu është dhe Sekretari i Përgjithshëm me stafin e KQZ-së. Kemi ndonjë kërkesë paraprake në raport me trupën tonë? Doni përjashtimin e ndonjërit?

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK:** Jo, nuk duam.

**Z. I. Rusmali:** Kolegët, kanë ndonjë deklaram? Nuk kanë, në rregull. Do na e prezantoni ju vetë kërkesën më mirë apo të them unë dy fjalë për të? Kërkesa ka për objekt detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'u pajisur subjektin kërkuar me vendimin e tij për votimin nga jashtë shtetit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur kërkesës është shkresa që Koalicioni i ka dërguar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nuk ka datë, gjithësi nuk është e rendësishme kjo gjë. Lidhur me elementët e formës ka ndonjë konstatim nga ana e Administratës?

**Z. Y. Merkaçaj:** Në lidhje me elementët e formës nga një shqyrtim paraprak që kemi bërë dhe verifikim të kërkesës ankimore rezulton se nuk i plotëson kërkesat e nenit 126 të "Kodit Zgjedhor" pasi nuk ka parashtruar se cila është shkelja që ka bërë KQZ-ja.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kush është komenti juaj për këtë konstatim nga ana e Administratës?

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK:** Të nderuar zotërinj të KAS, besoj se ne kemi shpjeguar në dokumentin e parë, KQZ-së për çështjen e shkeljes së ligjit zgjedhorë ku kemi shkelje në lidhje me votuesit nga jashtë shtetit të nenit 24 pika 4 dhe pika 3. Kështu që nëse do t'i hyjmë çështjes së formës e përmbajtjes që pretendon Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së do të kthehemi në një amulli ashtu sikurse do të vërtetohet hap pas hapi në këtë komision ankimor të nderuar, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Për të sqjaruar seancën e sotme, seanca e sotme nuk merret përgjithësisht me kërkesat ankimore që vinë, ka dy hapa. Hapi i parë është studimi i elementëve të formës me qëllim që KQZ-ja të vendosi do t'a pranojë t'a shqyrtojë apo jo. Nqs mungojnë elementët e formës ligji e detyron KQZ-në që ta refuzojë. Nqs elementët e formës janë ose plotësohen dot, KAS mund të marrë vendim për t'a kaluar për shqyrtim dhe kur merr vendim për ta kaluar për shqyrtim atëherë trajtohet përmbajtja. Domethënë, në këtë fazë nuk merremi me përmbajtjen e kërkesës, stafi, KQZ-ja konstaton që kërkesës i mungojnë elementët e formës ashtu siç e kërkon neni 126 i “ Kodit Zgjedhor”. Domethënë, konkretisht, ankesa duhet të vi si ankim ndaj një vendimi të Komisionerit ose të një KZAZ-je. Ankesa nuk ka referencë tek një vendim i Komisionerit ose një KZAZ-je për të cilën subjekti ankohet. Ankesa duhet të ketë të referuar bazën ligjore po i lexoj nga neni 126, bazën ligjore ku mbështetet duhet të ketë një përshkrim të shkurtër të shkeljeve të pretenduara, të ketë faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore dhe të thotë cilat janë provat ku mbështet pretendimin e vet. Ne shqyrtojmë në këtë fazë vetëm a është çështja kompetencë e jona, a i ka këto elementët e formës dhe a është paraqitur brenda afatit që përcakton ligji. Këto janë tre gjërat(hapat) që ne shqyrtojmë dhe jemi duke shqyrtuar vetëm këto tre gjëra, nuk futemi të përmbajtja vetëm kaq. Në lidhje me elementët e formës, ka reagim nga ju? Doni të reagoni apo?

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK:** Patjetër, që do reagojmë. Selami ke një reagim apo ta vazhdojë unë?

**Z. S. Jenihsheri, drejtues i ABEOK:** Tek neni 126 që ju sapo përmendët, forma dhe përmbajtja e ankimit kundër vendimit të KZAZ-së dhe vendimit të KQZ-së

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Nuk jemi tek ky objekt sepse ne nuk jemi ankuar për ndonjë vendim të KQZ-së as nuk jemi ankuar për rezultatin e zgjedhjeve të KQZ-së. Ne i kemi kërkuar institucionit të KQZ-së që të na japi aktin, vendimin me të cilin ajo ka vendosur vendimin që ka marrë në lidhje me votimin e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Pra, nuk jemi te neni 126 sepse ne, neni 126 na drejton për formën e përmbajtjen e ankimit kundër vendimit të KQZ-së. Ne nuk kemi ndonjë ankim sepse nuk dimë a ka marrë vendim apo jo. Megjithatë nga biseda që kemi bërë me Administratën, na thonë se ky vendim nuk është marrë akoma dhe ne na shqetëson kjo neglizhencë sepse ne jemi Koalicion me 4 parti. Një prej të cilavë është emigracioni.

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje kam për ju. Administarta e KQZ-së ka komunikuar me ju dhe ju ka thënë që ky vendim nuk është marrë akoma, siç na thatë tani. J'a u ka thënë me gojë, në rrugë informalë apo jua ka thënë me shkrim këtë gjë?

**Z. S. Jenihsheri, drejtues i ABEOK:** Unë kam biseduar me zotin Olsi dhe zonjën e protokollit dhe kur kam paraqitur kërkesën e fundit, pasi nuk kemi bërë vetëm këtë kërkesë kemi bërë disa që nga data 21 për më tepër, i jemi drejtuar dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta për të ndërhyrë tek KQZ-ja për të na dhënë këtë vendim, gjë e cila, megjithëse Presidenti ja ka bërë me dije këtë shqetësim dhe KQZ-ja vazhdon mos të na përfilli për të na e dhënë vendimin. Është e drejta jonë edhe si deputet që të marrin çdo dokument që nuk është sekret shteti nga statusi i deputetit që unë e disponojë. Nëqoftëse është marrë ai vendim na e jepni, nëse jo na thoni nuk është marrë, nuk ka ndonjë problem. Unë shoh nga mënyra sesi po bisedohet këtu, nuk shoh se keni ndonjë vullnet që të na pajisni me atë vendim por është e drejta jonë.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** A mund të flas unë tani... Të lutem, se unë e morra përgjigjen e pyetjes dhe është më mirë që të komunikojmë pa paragjykime dhe me ciltërsinë e njëri-tjetrit sepse ndonjëherë kur shtojmë fjalë në vend që të sqarohemi ngatërrojmë. Dua të bëj pyetjen: Kërkesa vjen si koalicion apo si deputet? Se është trajtim tjetër si koalicion e tjetër si deputet. Ju sapo na thatë që si deputet kërkoj informacionin. A na e sqaroni dot me një fjali këtë? I qëndroni kërkesës si koalicion apo kërkesa vjen si deputet?

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK:** Zoti Rusmali, faleminderit. Ju keni shkresën përpara, pavarësisht se kolegu Jenihsheri shtoi dhe të drejtën e deputetit për informim, ne në këto momente jemi zyrtarisht përballë jush si Koalicioni ABEOK. Në këto kushte ABEOK kërkon...

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Të lutem përgjigjen e mora, kot të shtojmë fjali!

**Z. K. Gjuzi përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Zoti Rusmali mos më ndërprit, nuk të ndërpreva, nëse ju e morët përgjigjen të lutem...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem unë tani, të kuptosh një gjë, këtu ke ardhur, ke një trup, këtë takim, këtë seancë e drejtoj unë jo ti.

**Z. K. Gjuzi përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** E para njëherë mos mu drejto ti, mu drejto me etikë. E dyta, zoti Rusmali do të lutem shumë ju mund të drejtoni trupën nëse doni....

**Z. I. Rusmali:** Po të kërkoj të mbash qetësi, që të lejosh që të zhvillohet mbledhja.

**Z. K. Gjuzi përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Nëse doni të bashkëbisedoni....

**Z. I. Rusmali:** Fjalën t'a jap unë! Fik mikrofonin! Fjalën t'a jap unë, përgjigjesh pyetjeve të mia. Nuk e drejton ti këtë mbledhje.

**Z. K. Gjuzi përfaqësues i ABEOK-së:** Edhe njëherë mos mu drejto me ti se ndryshe pastaj do t'i kërkoj leje kryetarit të KAS që të....

**Z. I. Rusmali:** Incidente në këtë sallë nuk ndodhin kurrë. Do t'i përgjigjeni pyetjeve ose do refuzoni t'i përgjigjeni pyetjeve. Por pazar nuk e bëni dot, tani të lutem shumë kam ende pyetje për të bërë. Do përgjigjeni apo t'a mbyllim shqyrtimin këtu. Atëhere, prit të bëj pyetjen dhe me leje, dhe vetëm përgjigje për pyetjen asnjë gjë

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

më shumë. Sqaruar që kërkesa vjen nga koalicioni nuk vjen nga deputet, e para. E dyta, lidhur me objektin e kërkesës nga ana siç komentuat vetë, siç thatë vetë, siç e pohuat vetë, nga ana e administratrës së KQZ-së i'u është thënë që një vendim, vendimi që ju kërkonti nuk ekziston. Ju në objekt të kërkesës keni insistuar dhe keni thënë që kërkojmë të n'a jepet vendimi. Çfarë ka që nuk shkon tek përgjigja që vendimi nuk ekziston, se kërkonti një gjë që nuk ekziston? Të lutem e kuptuat pyetjen? Vetëm për pyetjen që i'u bëra jo për gjëra të tjera.

**Z. S. Jenihsheri përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Të përgjigjem unë për këtë. Ne kemi bërë disa kërkesa dhe na janë refuzuar përgjigjet, dhe këto herët e fundit, kur ke ardhur ti herën e fundit. Është bërë kjo kërkesa na është thënë, është dhënë përgjigja që në datë 6. Ajo përgjigje nuk është përgjigja e kësaj kërkesë që kemi bërë ne zoti Rusmali, ajo është tek ajo kërkesë na u dha një përgjigje nga KQZ. Nuk kemi ardhur këtu, kemi ardhur me fol ndershmërisht këtu, na është dhënë përgjigje që ky vendim nuk është marrë është në procedura në konsultime të përfaqësuesve të partive politike dhe të diasporës. Kjo ka qenë përgjigja Një minutë të lutëm të sqarojë pak, ne jemi pajtuar me përgjigjen edhe po presim, po edhe ne vetë jemi përfaqësuesit e partive politike me ne nuk ka bërë njeri ndonjë konsultë. Atëhere, jemi drejtuar me një kërkesë tjetër edhe përsëri me një tjetër, i jemi drejtuar edhe Presidentit, nuk e shoh se ka ndonjë problem këtu, në qoftë se është bërë vendimi të na jepet vendimi. Në qoftë se nuk është bërë siç na thonë tek protokollin mesa di unë....

**Z. I. Rusmali:** Që të kuptojë saktë atë që më thatë tani, ju doni të përfshihen në procedurën që është në shqyrtim për këtë çështje sepse edhe ju jeni përfaqësues. Kjo është kërkesa? Edhe njëherë ju thatë që administrata iu ka thënë që për këtë nuk ka vendim dhe çështja është në proces shqyrtimi në konsultë me partitë politike, me

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

diasporën e tjera e tjera dhe ju doni të përfshiheni në këtë proces. Sapo thatë që edhe ne përfaqësues jemi. Doni të përfshiheni në këtë proces. Kush është qëllimi? Na i shpjegon dot qëllimin? Se vendimi nuk ekziston, ne nuk iu japim dot një gjë që nuk ekziston. Nuk jepet një gjë që nuk ekziston. Dokumenti nuk ekziston. Pyetja është shumë e thjeshtë. Dokumenti nuk ekziston nuk është prodhuar akoma një gjë...


**Z. S. Jenihsheri përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Nuk e kuptoj pse nuk më lë me fol, e kam të thjeshtë pyetjen. Unë e kam kërkuar këtë vendim, është bërë ai vendim na i jepni përndryshe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thotë ky vendim nuk është bërë.

**Z. I. Rusmali:** Zoti Merkaj a ekziston vendimi që kërkojnë zotërinjt?

**Z. Y. Merkaj:** Jo! Nuk ekziston vendimi. Është e vërtetë që koalicioni ABEOK ka bërë disa kërkesa në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nëpërmjet përfaqësuesve i kemi kthyer përgjigje edhe me email, i kemi kthyer përgjigje edhe me shkresë.

**Z. I. Rusmali:** Qartë! Stafi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më vë në dispozicion shkresën me numër protokoll 3276\1 datë 07.04.2021 të komisionit drejtuar koalicionit ABEOK. Shkresa thotë këtë gjë, në përgjigje të kërkesës tuaj, siç iu kemi kthyer përgjigje edhe me email. Ju bëj me dije se KQZ është në proces konsultimi me përfaqësues të partive politike, përfaqësues të organizatave të diasporës si dhe është në procesin e hartimit të rregullave të detajuara për të mundësuar 4votimin e bashkëatdhetarëve tanë në diasporë. Pra, kjo shkresë thotë që nuk kemi vendim, jemi duke e punuar. Tani është e qartë shkresa për ju?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. S. Jenihsheri përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Jo!

**Z. I. Rusmali:** Po pse nuk është e qartë? Po vetëm shkurt.

**Z. S. Jenihsheri përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thotë, që ne jemi në procedura, për t'u konsultuar me përfaqësuesit e partive politike dhe diasporës. Atëhere, ne jemi katër deputet dhe përfaqësues të partive politike. Të katërt jemi kryetar partie dhe këtë gjë që thotë vetë KQZ nuk është e vërtet. Ne nuk duam sherr dhe nuk kemi ardhur këtu të bëjmë fjalë e sherr. Nuk jemi njerëz sherresh ne këtu, ne kemi ardhur vetëm për t'iu kërkuar ju a do na i jepni atë vendim në qoftë se e keni bërë, në qoftë se nuk është bërë na i thoni dhe shkojmë në punën tonë. Për çfarë i zgjasim kaq shumë po e drejta jonë për t'ia u kërkuar kur kemi bërë kaq shumë...

**Z. I. Rusmali:** Zoti Gjuzi, është e qartë çështja?

**Z. K. Gjuzi përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Zoti Gjuzi në asnjë vend të Kodit Zgjedhor të miratuar, nuk thotë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën konsulenca me partitë politike për ligjshmërinë dhe rrespektimin e Kodit Zgjedhor. Ky është handikapi që ne tashmë e kemi kap dhe kemi ardhur dhe ju kemi respektuar edhe ju duke iu drejtuar kërkesën që ka një shkelje ligjore Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Prandaj ju do të merrni vendimin tuaj, ne na intereson vendimi juaj për të parë .... Pra, ne kërkojmë nga ju i nderuar zoti Rusmali dhe trupa juaj e komisionit të ankimeve. Të na vini në dispozicion vendimin tuaj vendimin tuaj, sepse në shkresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë përfshirë elementë të cilët ndërhyjnë në situatën zgjedhore dhe kjo tashmë ka ndodhur. Sepse siç e shikoni data është e 7

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Prillit domethënë është një skandal dhe ne këtë skandal nuk do t'a lejojmë, deri në minutën e fundit. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** E qartë. Pyetje nga kolegët? Nuk kemi! Ne do e mbyllim këtu shqyrtimin, keni ndonjë gjë tjetër për të thënë nuk besoj se ka? Po patjetër zoti Selami!

**Z. S. Jenihsheri përfaqësues i koalicionit ABEOK-së:** Unë kërkoj nga ky komision i KAS-it seriozitet e cila sipas meje dhe vullnet për t'i dhënë jetë ligjit, për t'a zbatuar ligjin.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë ne do e mbyllim këtu shqyrtimin, kemi ndonjë gjë tjetër për të thënë, s'besoj se ka? Po, patjetër!

**Z. K. Gjuzi, përfaqësues i ABEOK-së:** Unë kërkoj nga Komisioni i KAS-it seriozitet, e cili sipas meje, dhe vullnet, për t'i dhënë jetë ligjit, për ta zbatuar ligjin dhe nëse është bërë ky gabim sipas nesh, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk e ka marrë këtë vendim që e ka me detyrim ligjor, sipas nenit 24, pika 3 dhe 4, atëherë këtu është krejt e thjeshtë, ne s'po kërkojmë asgjë, na bëj këtë shkresë këtu, a bën ky dokument, për të na dhënë, nuk ka bërë, thoni s'e kemi bërë, për probleme të tjera, muhabete të tjera janë tepër këtu. Nuk kemi ardhur këtu për të bërë kritika ndaj KQZ-së, se si funksionon, çfarë duhet bërë, a duhet të thirrshim edhe ne? I lëmë këto punë, këtu jemi vetëm për një pyetje të thjeshtë që ju kemi bërë? A ka mundësi, meqenëse KQZ-ja nuk na e jep, dhe për ne është shkelje, nuk na e jep këtë letër, në qoftë se është, ai duhet të na e japë në qoftë se është. Në qoftë se nuk është duhet të na thonë që nuk është marrë ky vendim. Kaq!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit! KAS-i mbyll këtu shqyrtimin paraprak të çështjes dhe duhet të tërhiqet për të marrë vendim nëse do ta pranojë këtë kërkesë ankimore apo jo? Ju lutem do të na falni të paktën 2 minuta, sa të mund të konsultohemi me njeri-tjetrin dhe ju thërrasim menjëherë për ta shpallur vendimin.

**Rifillon seanca**

**Ora 12:12**

**Z. I. Rusmali:** Mirë, atëherë riçelim seancën. KAS-i pasi e shqyrtoi çështjen dhe dëgjoi debatin midis palëve, doli në vendimin për mospranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore. Arsytimin do ta merrni të detajuar me shkrim, por thelbin e arsyetimit unë po jua them me gojë, që të jemi të qartë për gjënë. KAS-i ka kompetencë ligjore të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kjo kërkesë që ju keni paraqitur nuk është e kësaj natyre, nuk është as ankim nga një vendim i ndonjë KZAZ-je, as nga një vendim të Komisionerit. Për nga natyra e saj, ajo është një kërkesë për informacion dhe rregullohet nga dispozitat e ligjit për informimin publik, i cili parashikon procedura të tjera ankimimi në rast se institucioni nuk kthen përgjigje, pra për të shpjeguar kush është konteksti i gjësë. Sa kohë që çështja nuk është kompetencë e jona, ne nuk i futemi dot thelbit të saj. Nuk diskutojmë dot, a ju ka kthyer përgjigje apo s'ju ka kthyer përgjigje KQZ-ja. A e ka kthyer të saktë përgjigjen KQZ-ja apo e ka kthyer të pasaktë, sepse ne nuk na lejohet të merremi fare me kërkesa të kësaj natyre. Kjo do të jetë thelbi i vendimit që ne do marrim, sigurisht që ndaj këtij vendimi ju keni të drejtën e ankimit. Sa kohë që kjo është e natyrës, domethënë duhet të shohim pak të drejtën e ankimit, se nuk mund të jetë, duhet të jetë Gjykata

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Administrative besoj unë, sa kohë që nuk është e natyrës zgjedhore kërkesa, e drejta e ankimit duhet të jetë në Gjykatën Administrative, por sqarimin ligjor për këtë do ta merrni bashkë me vendimin. Këtu e mbyll shqyrtimin e kësaj çështjeje. Ju do rrini se kemi dhe një çështje tjetër prapë ne.

**Vendim nr. 69**

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

11.05.2021  
Ora10:40

**RENDI I DITËS**


**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 46 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.340, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për  
deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të  
subjektit ankues LSI".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj.
- **Parti Politike:**

**Z. E. Çefa:** Atëherë çelim seancën e verifikimit paraprak të kërkesës ankimore numër 46, datë 09.05.2021 me subjekt ankues Partia Lëvizja Socialiste për Integrim me objekt ankimi ndryshimi i vendimit të komisionerit Shtetëror numër 340 datë 04.05.2021 për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e votimit të Qarkut Durrës dhe rinumërimin dhe rivlersimin e votave për të gjitha ZAZ e Qarkut Durrës. Sipas shortit hedhur ditën e djeshme relatori i kësaj kërkesa jam caktuar unë Elvis Çefa. Subjekti nuk është prezent në këtë seancë paraprake të vlerësimit. Nga anëtarët e KAS-it nuk ka ndonjë deklaratë lidhur me konfliktet e mundëshme interesi. Në këtë kontekst vijojmë me vlerësimin e kritereve në kuptim të nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Sekretari i përgjithshëm ka ndonjë element për tu shënuar në këtë pikë lidhur me anën formale?

**Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merhaj:** Nga verifikimi i kërkesës plotëson formën e përmbajtjen e parashikuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor si dhe nenin 130 të Kodit Zgjedhor.

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit atëherë sipas procedurës se KAS-it konsultuar në vend, vendos kalimin për shqyrtimin të kësaj kërkesë duke qenë se bëhet fjalë për ankimimin e vendimit numër 340 të Komisionerit Shtetëror, i cili është gjithashtu objekt ankimimi edhe në kërkesën ankimore me numër 37 ku relator është zoti Koli Bele. Unë propozoj me bashkimin e këtyre dy kërkesave dhe relator i të dyjave të jetë zoti Koli Bele. Seanca e shqyrtimit në themel të çështjes është caktuar nesër më datën 12 Maj, në orën 12:00, dakord? Seanca deklarohet e mbyllur faleminderit .

**Vendimi nr.70**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

11.05.2021  
Ora 12:33

**RENDI I DITËS**

Projektvendim "Për shqyrtimin paraprak i Kërkesës Ankimore nr.47 me objekt Kundërshtimi i vendimit nr.343, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit ankues Lediana Fratari (kandidat për deputet, qarku Tiranë, PD-AN).

**PJESËMARRJA :**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. K. Bele:** Pra, vazhdojmë me Kërkesën Ankimore nr. 47, të datës 10.05.2021 me ankuese kandidaten Lediana Fratari, kandidate për deputete pjesë e Koalicioni PD-AN, e cila ka paraqitur një ankesë me objekt kërkesë për rinumërimin e votave për kandidate në Qarkun e Tiranës dhe pika e dytë kundërshtimin e vendimit të KZAZ-ve. Sipas shortit relator jam unë Koli Bele dhe relatohet që kandidatja është njoftuar por nuk është paraqitur në orarin e komunikuar. Në këto kushte nuk ka

1

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

pengesë dhe vazhdon shqyrtimi i kësaj kërkesë. Në këtë fazë të kandidatit, sekretar i përgjithshëm çfarë qëndrimi kemi për elementet e formës?

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se kërkesa ankimore është nënshkruar dhe firmosur nga kandidatja për deputete në listën shumëmemërore. Kështu që nuk plotëson një nga elementet e nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe 130 pasi nuk legjitimohet në mbledhjen e kësaj kërkesë.

**Z. K. Bele:** Faleminderit, pyetje të tjera nuk kemi. Atëherë KAS tërhiqet për vendim.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 12:37**

**Z. K. Bele:** KAS vendosi: Mospranimin e kërkesës ankimore pasi nuk plotëson element të formës dhe përmbajtjes sipas rregullimit përkatës nga nenet 124 dhe vijues të Kodit Zgjedhor.

**Vendimi nr. 71**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**11.05.2021  
Ora10:45**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 48 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet  
në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit  
ankues LSI".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj. O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. L. Braho:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 346 datë 04.05.2021, ka vendosur Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatet e votimit të zonës zgjedhore Qarku Korçë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ndaj këtij vendimi ka depozituar ankim subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Ky ankim është depozituar pranë KQZ, me datë 10.05.2021 dhe është regjistruar në bazë të nenit 127 të Kodit Zgjedhor si kërkesa ankimore numër 48. Pas hedhjes së shortit nga KQZ, kjo kërkesë ankimore më është caktuar mua anëtarit Ledio Braho si relator, ndaj sot po zhvillojmë brenda afatit të përcaktuar të Kodit Zgjedhor seancën për verifikimin e plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kësaj kërkesë ankimore. Zoti Sekretar i Përgjithshëm në lidhje me elementët e formës dhe të përmbajtjes të pjesës ankimore të kësaj kërkesë?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi i kërkesës ankimore konstatohet se kërkesa ankimore me numër 48, e paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Pasi përmban emrin e subjektit dhe adresën e tij, referon vendimit që ankimohe, përshkruan bazën ligjore përshkruan gjykimin mbi shkurtimin e shkeljes së pretenduar, ka përshkruar fakte dhe argumentat në të cilat mbështetet dhe ankimi tregon provat të cilat kërkon të marrin gjatë shqyrtimit administrativ si dhe është caktuar data dhe firma ankimesit. Gjithashtu plotëson elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, ka respektuar afatin ligjor të paraqitur të ankimit, legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë dhe i drejtohet KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit për detajet në këto kushte KAS i konsultuar në vend në zbatim të nenit 129 pika 3, shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, vendos kalimin e kërkesës numër 48, të depozituar nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Për shqyrtim dhe po ashtu unë, në cilësinë e relatorit të kësaj kërkesë ankimore duke konstatuar se ka dhe një kërkesë tjetër ankimore të depozituar në lidhje me Qarkun Korçë nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 132, pika 1, të Kodit zgjedhor, propozoj që kjo kërkesë ankimore pra kërkesa ankimore me numër 48 të bashkohet me kërkesën ankimore numër 43 dhe të shqyrtohen bashkarisht në zbatim të këti neni në relatimin e anëtarit Elvis Çefa. Kështu që dhe orari i zhvillimit i seancës administrative duke qenë se do të bashkohet do të bëhet njëkohësisht me atë të kërkesës ankimore numër 43. Nesër, me datë 12 Maj 2021, në orën 14:00, faleminderit.

**Vendimi nr.72**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora10:48**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 49 objekti  
"Kundërshtimi i vendimit nr.345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin në zonën  
zgjedhore Qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet  
në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 të subjektit  
ankues LSI".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj. O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. E. Lako:** Atëherë çelim seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për verifikimin dhe plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes së ankimit numër 49, të subjektit ankues Lëvizja Socialiste për Integrim. Me objekt ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 345 datë 04.05.2021. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Qarkun Vlorë si dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë qark. Relatori i kësaj çështje jam zgjedhur unë Elvin Lako sipas shortit të hedhur sot, në datën 11 Maj 2021 bazuar në nenin 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e komisionit të akimeve dhe sanksioneve, anëtari i përgjithshëm dhe KQZ. Subjekti ankues nuk është megjithatë vazhdojmë shqyrtimin. Dy fjalë nga elementët e formës dhe të përmbajtjes nga sekretari i përgjithshëm.

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi i kërkesës ankimore numër 49 është paraqitur nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Konstatohet se plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor pasi përmban emrin e subjektit dhe adresën e tij, referimin e vendimit që ankimohet, përshkruan bazën ligjore ku mbështete ankimi ka përshkruar shkurtimin e pretenduar, ka përshkruar dhe dispozitën ligjore në të cilën mbështetet ankimi, tregon provat të cilat kërkohen të marrin gjatë procesit të shqyrtimit administrativ si dhe është data dhe firma e ankimesit. Gjithashtu plotëson elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor ka respektuar afatin ligjor të ankimit, legjitimohet në ngritjen e kësaj ankese si dhe i drejtohet KAS-it si organi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit meqëse se nuk ka ndonjë pyetje apo kërkesë nga anëtarët e komisionit, atëherë duke pasur parasysh bazën ligjore dhe provat e dokumentuara Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave të formës dhe të përmbajtjes. Të vendosim kalimin e këtij ankimi për shqyrtim, meqënëse objekt i kësaj këkese ankimore është shqyrtimi i vendimit numër 345 datë 04.05.2021, që ka të bëjë me Tabelën e Rezultateve në Qarkun Vlorë. Atëherë meqëse se kërkesa ankimore numër 36 e bërë nga subjekti ankues Partia Demokratike ka të bëjë me rezultatet e kësaj zone zgjedhore, atëherë propozoj që edhe ky ankim të bashkëngjitet dhe të bashkohet me ankimin numër 36 të subjektit ankues Partia Demokratike Dakord? Arëherë KAS vendosi që edhe ky ankim të bashkohet me mbështetjen e nenit 132 me ankimin numër 36. Relatori i asaj çështjeje jam përsëri unë, kështu që unë jam relatori i çështjes përfundimtare. Kështu që seanca e radhës do të lihet me datën 12.05.2021 ora 11:30, faleminderit.

**Vendimi nr.73**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*





**11.05.2021  
Ora 12:15**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr.50, me objekt "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Qarkun Tiranë, të subjektit ankues z.Kostaq Papa, kandidat për deputet, Qarku Tiranë, ABEOK".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** Z.K.Papa (ABEOK)

**Z. E. Çefa:** Atëherë, çelim seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore nr.50, datë 10.05.2021, paraqitur nga kandidati, zoti Kostaq Papa dhe nga, por kjo është pak e paqartë, duhet të jetë subjekt sqarimi dhe nga koalicioni ABEOK. Në bazë të shortit të hedhur nga KQZ, relatori i kësaj çështjeje jam caktuar unë, Elvis Çefa, anëtar i KAS-it. Janë prezentë në seancë zoti Kostaq Papa dhe përfaqësues të koalicionit ABEOK. Përpara se të fillojmë keni ndonjë kërkesë paraprake lidhur me përbërjen e trupës të KAS-it?

**Z. K. Papa, përfaqësues i koalicionit ABEOK:** Jo, jemi dakord!

**Z. E. Çefa:** Dakord! Nga anëtarët e KAS-it nuk ka ndonjë deklaratë për konflikt interesi, kështu që mund të vazhdojmë. Atëherë, për ta sqaruar pak situatën do të theksoj dhe njëherë zoti Papa, meqenëse ju jeni subjekti kryesor ankimues, që jemi

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

në seancën paraprahe, sot do merret vendim nëse kjo çështje do kalojë në seancë themeli, ose nuk do kalojë. Kështu që unë shkurtimisht meqenëse më rezulton që ka disa elemente formale të paqarta në kërkesë, ju ftoj që shkurtimisht na sqaroni pak lidhur me objektin e ankimit.

**Z. K. Papa, përfaqësues i koalicionit ABEOK:** Faleminderit! Edhe pse unë faktikisht nuk jam njoftuar për këtë seancë, megjithatë meqenëse ndodhem dhe është procedura, le ta vazhdojmë dhe nuk ka ndonjë problem. Ankimimi ka të bëjë me mosnjohjen e rezultatit të zgjedhjeve në të gjitha KZAZ-të e Tiranës, ku unë kam qenë kandidat, në emër të Emigracionit Shqiptar dhe të koalicionit ABEOK. Parë nga këndvështrimi juridik i të gjitha procedurave që kanë ndodhur rezulton, duke ndjekur dhe rrjetet sociale dhe median dhe gjithë problematikat e tjera, shohim që rezultati i votës së qytetarëve nuk ka përfunduar ashtu si duhet dhe kjo tregon që, tabelat në të cilat janë organizuar nga KZAZ-të dhe më pas janë njohur nga KQZ-ja, nuk janë tabela reale, nuk kanë vlerësim real të realitetit. Kjo ka të bëjë me, nuk themi me ditën e zgjedhjeve, por ka të bëjë me ditët e numërimit të votave ku konstatohen dhe janë parë dhe kanë qarkulluar në media, dhjetëra video për ndryshimin dhe tjetërsimin e votës. Tjetërsim në ndryshim, domethënë nxjerrje të pavlefshme të votës dhe kalim të votës nga kandidatët tanë në kandidatë të tjerë.

**Z. E. Çefa:** Zoti Papa, këto janë elemente të themelit. Atëherë për ta bërë ndoshta pak më të qartë. Unë kam disa pyetje dhe në qoftë se ju do të mundeni, do të kërkoj të më jepni një përgjigje. Atëherë e para, kjo kërkesë është paraqitur nga koalicioni ABEOK, apo nga ju si kandidat?

**Z. K. Papa, përfaqësues i ABEOK:** Nga unë dhe nga Koalicioni ABEOK.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**Z. E. Çefa:** Ju e dini që në KAS ankimohen vendimet e KZAZ-së apo të Komisionerit. Tani, a mund të na sqaroni meqënëse ju nuk e keni parashtruar në ankim ndaj kujt vendimi paraqitet ky ankim?

**Z. K. Papa, përfaqësues i ABEOK:** Të gjithave vendimeve të KZAZ-ve në Tiranë, të Qarkut të Tiranës, sepse Tirana nuk ka një KZAZ.

**Z. E. Çefa:** Pra nuk i keni sqaruar, arsyet që ankimoni këtë vendim pak a shumë i shpjeguat por kjo është diçka që i takon themelit. Referuar nenit 126, të Kodit Zgjedhor ju keni detyrimin të bashkëlidhni ankimit tuaj prova apo të referoni dhe të kërkoni nga KAS-i, marrjen e provave të caktuara që mund të shërbejnë për vërtetimin e pretendimeve tuaja. Unë shoh që në ankim nuk keni asnjë provë bashkëlidhur, do të më sqaroni nëse keni prova shtesë.

**Z. K. Papa, përfaqësues i ABEOK:** Unë kam disa prova për momentin nuk i kam këtu. Kanë të bëjnë me disa video që kanë qarkulluar në median sociale ku duken qartë që numërues ndryshojnë në fletën e votimit votën e qytetarit.

**Z. E. Çefa:** Por nuk i keni cituar.

**Z. K. Papa, përfaqësues i ABEOK:** Është e cituar te faqja e fundit. Nuk e kam cituar si rast po them është përmendur si fakt.

**Z. E. Çefa:** Të cituara dhe të emërtuara secila dhe të jenë të bashkëlidhura ankimet. Ndonjë gjë tjetër nuk keni? Administrata ndonjë gjë?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankisoneve  
Dt.11.05.2021*

**Z.Y. Merkaç:** Nga verifikimi i kërkesës ankimore të paraqitur nga Kostaq Papa dhe Koalicioni ABEOK, konstatojmë se i mungon elementi referimi nga vendimi që ankimohet parashikuar pika 1, germa “b”, e nenit 126 dhe i propozojnë Komisionit Ankimimeve dhe Sankisoneve kthimin e kërkesës për plotësim të elementit të formës bazuar në nenin 129 të Kodit Zgjedhor.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, pyetje tjera nga kolegët nuk ka? Do t’ju kërkojmë prapë një 5 minutësh kohë ju lutem sa të konsultohemi.

KAS-i i konsultuar në vend konkludon që të kthehet për plotësim Kërkesa Ankimore nr.50, e paraqitur nga Koalicioni ABEOK dhe kandidati zoti Kostaq Papa. Për plotësimin e kësaj ankese të gjitha dokumentat e nevojshme që ne i cituam këtu dhe që dolën dhe nga debati i zhvilluar në seancë do të keni 24 orë kohë. Do të depozitoni të gjitha provat që keni, do të sqaroni pretendimet meqënëse se ka disa pretendime kontradiktore dhe do të duhet të citoni dhe vendimet ndoshta dhe në bashkëpunim me Administratën e KQZ-së të citoni vendimet konkrete që ankimoni. Për këtë arsye keni 24 orë kohë ne do jua japim vendimin të zbardhur me shkrim që të plotësoni ankesën dhe më pas ne të kemi mundësi të fillojmë trajtimin e saj në themel. Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr 74**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**11.05.2021  
Ora 12:23**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.51 me objekt Kundërshtimi i vendimit nr.343, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Tiranë të subjektit ankues zoti Bojken Abazi kandidat i propozuar nga zgjedhësit".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. L. Braho:** Atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.343 datë 04.05.2021, ka vendosur miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të zonës zgjedhore Qarkut Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ndaj këtij vendimi në datën 10.05.2021, ka bërë ankim subjekti zgjedhor kandidati i propozuar nga zgjedhësit zoti Bojken Abazi, që ka qenë kandidat në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë. Në bazë të nenit 127, të Kodit Zgjedhor, kjo kërkesë ankimore është regjistruar pranë regjistrit të ankimeve nr.51. Objektin e ankimit zoti Bojken Abazi kërkon shpalljen e pavlefshmërisë për tabelat të rezultatit për zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë. Kjo është seancë e verifikimit të formës dhe përmbajtjes në zbatim të neneve 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor kështu që i lutemi

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

Administratës së KQZ-së të na bëjë një rezume në qoftë se kërkesa është në përputhje me këto nene.

**Z.Y.Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti Bojken Abazi, kandidati i propozuar nga zgjedhjet për zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, konstatohet se janë në përputhje me nenin 126, të Kodit Zgjedhor, i cili përmban element të poshtëm të parashikuara nga ky nen tyë elementit të formës dhe të përmbajtjes si dhe është respektuar dhe neni 130 i Kodit Zgjedhor. Afati i paraqitjes së kërkesës, legjitimimi i ankuesit i cili legjitimohet në mbledhjen e kësaj kërkesë ankimore. Gjithashtu i është drejtuar KAS-it si institucioni që shqyrton ankimet dhe vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Atëherë KAS-i i konsultuar në vend duke arritur në përfundimin që plotësohen kërkesat në lidhje me formën dhe përmbajtjen të Kërkesës Ankimore nr. 51, në zbatim të nenit 129, pika 3, shkronja “a”, vendos kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim.

**Vendimi nr. 75**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

11.05.2021  
Ora 12:27

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.52 me objekt Kundërshtimi i vendimit nr.347, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë." të subjektit ankues zoti Kreshnik Merxhani**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. I. Rusmali:** Në KAS është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 52, nga subjekti zgjedhor Kreshnik Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit. Objekti i kërkesës ankimore është shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Ankuesi nuk është prezent, është njoftuar për zhvillimin e seancës, por ndodhet prezente Administrata e KQZ-së, nga ana e sekretarit të përgjithshëm ka ndonjë konstatim lidhur me elementet formale të kërkesës?

**Z.Y.Merkaj:** Nga verifikimi i kërkesave ankimore rezulton se kërkesa ankimore plotëson elementet e formës dhe përmbajtjes të parashikuara në nenin 126, të Kodit Zgjedhor pasi përmban emrin e subjektit që ankimon dhe adresën e tij. Referon në vendimin që ankimohet përmban bazën ligjore ku

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

mbështetet ankimi përshkrimin e shkurtër së pretenduar. Përshkrimin e fakteve argumentave, të cilat mbështeten ankimi si dhe tregon provat të cilat kërkohen të merren gjatë shqyrtimit. Është paraqitur data dhe nënshkrimi i ankimuesit gjithashtu përmbush dhe elementet e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, është brenda afatit të përcaktuar në ligj paraqitja e ankimit. Legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë. Gjithashtu i është drejtuar KAS-it si institucioni i cili shqyrton vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit kërkesa drejtohet kundër vendimit nr.347 datë 04.05.2021, të Komisionerit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të zonës zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Këtu mbylлим shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë.

**Vendimi nr.76**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





**11.05.2021  
Ora 12:31**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.53 me objekt Kundërshtimi i vendimit nr.349, datë 04.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, të subjektit ankues zoti Iljaz Shehu kandidat i propozuar nga zgjedhësit".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. K. Bele:** Çelim seancën për Kërkesën Ankimore nr.53 me ankues Iljaz Shehu subjekt kandidat i propozuar nga zgjedhësit dhe kundër vendimit me objekt kërkesë: Për shpalljen në zonën zgjedhore Qarku Lezhë. Sipas shortit të hedhur relatori i kësaj çështje jam unë Koli Bele. Pala është njoftuar dhe është prezent. Administrata relatton, pala është njoftuar dhe ka pranuar të vazhdojë shqyrtimi në mungesë. Sekretari i përgjithshëm çfarë qëndrimi ka për elementet e formës së kësaj kërkesë?

**Z.Y.Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se elementet e formës dhe përmbatjes plotësohen sipas nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor si dhe elementet e formës plotësojnë pasi respektohet afati i ankimit

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

legjitimohet në lidhjen e kësaj kërkesë dhe i është drejtuar KAS-it si institucionit që shqyrton anën e vendimit e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Z. K. Bele:** Atëherë nëse nuk ka ndonjë pyetje nga kolegët KAS i konsultuar në vend vendos: Kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim dhe caktimi në seancës ditën e nesërme datë 12:05.2021, ora 15:00, faleminderit.

**Vendim nr.77**

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.11.05.2021*

**11.05.2021  
Ora 12:31**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.33 dhe Kërkesës Ankimore nr.41".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. L.Braho:** Janë dhe dy kërkesa të tjera ankimore njëra që është e Lëvizjes Socialiste për Integrim për Qarkun Gjirokastrë që është Kërkesa Ankimore nr.33 dhe tjetra është Kërkesa Ankimore e Partisë Demokratike po për Qarkun Gjirokastrë që është Kërkesa Ankimore nr.41. Për këto dy të parat kemi vendosur bashkimin në bazë të nenit 132. Kështu që po të njëjtin arsyetim ligjor edhe kërkesa e subjektit zgjedhor kandidati i propozuesit nga zgjedhësit Kreshnik Merxhani bashkohet me dy kërkesat të mëparshme dhe shqyrtohet bashkarisht me to në seancën e nesërme që është në orën 09:30.

**Vendimi nr. 78**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



11.05.2021  
Ora 09:59

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.35 dhe Kërkesës Ankimore nr.34"**

**PJESËMARRJA :**


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. K.Bebe:** Nga verifikimi i kryer për elementët e formës dhe përmbajtjes të këtij ankimi rezultojnë të jenë konform me nenin 124 dhe vijues të kodit. Në këtë kuptim duke analizuar sa më sipër, propozoj kalimin e çështjes për shqyrtim. Duke konstatuar se në vendimin eventual të pranimit të kësaj çështje nga KAS do të kemi dhe element të bashkimit në kuotim të nenit 132 të kodit. Pasi bëhet fjalë për kërkesa ankimore që kanë të bëjnë me një zonë zgjedhore. Në këtë rast Qarku Berat. Pra, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- 1.Kalimin e çështjes për shqyrtim.
  - 2.Bashkimin e kësaj çështje në kërkesën ankimore të të njëjtit subjekt me nr. 34.
- Me relator zotin Elvis Çefa, faleminderti.

**Vendimi nr. 79**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALHLLARI*



**11.05.2021  
Ora 10:49**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.36 dhe Kërkesës Ankimore nr.49"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. E. Lako:** Faleminderit meqëne se nuk ka ndonjë pyetje apo kërkesë nga anëtarët e komisionit, atëherë duke pasur parasysh bazën ligjore dhe provat e dokumentuara Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave të formës dhe të përmbajtjes. Të vendosim kalimin e këtij ankimi për shqyrtim, meqënë se objekt i kësaj këkese ankimore është shqyrtimi i vendimit numër 345 datë 04.05.2021, që ka të bëjë me Tabelën e Rezultateve në Qarkun Vlorë. Atëherë meqëne se kërkea ankimore numër 36 e bërë nga subjekti ankues Partia Demokratike ka të bëjë me rezultatet e kësaj zone zgjedhore, atëherë propozoj që edhe ky ankim ti bashkëngjitet dhe të bashkohet me ankimin numer 36 të subjektit ankues Partia Demokratike Dakord? Arëherë KAS vendosi që edhe ky ankim të bashkohet me mbështetjen e nenit 132 me ankimin numër 36. Relatori i asaj çështje jam përsëri unë, kështu që unë jam relatori i çështjes përfundimtare. Kështu që seanca e radhës do të lihet me datën 12.05.2021 ora 11:30, faleminderit.

**Vendimi nr.80**

1

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**11.05.2021  
Ora 10:40**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.37 dhe Kërkesës Ankimore nr.46"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit atëherë sipas procedurës së KAS-it konsultuar në vend, vendos kalimin për shqyrtimin të kësaj kërkesë duke qenë se bëhet fjalë për ankimimin e vendimit numër 340 të Komisionerit Shtetëror, i cili është gjithashtu objekt ankimimi edhe në kërkesën ankimore me numër 37 ku relator është zoti Koli Bele. Unë propozoj me bashkimin e këtyre dy kërkesave dhe relator i të dyjave të jetë zoti Koli Bele. Seanca e shqyrtimit në themel të çështjes është caktuar nesër më datën 12 Maj, në orën 12:00, dakord? Seanca deklarohet e mbyllur faleminderit .

**Vendimi nr. 81**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**11.05.2021  
Ora 10:46**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.43 dhe Kërkesës Ankimore nr.48"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. L. Braho:** Faleminderit për detajet në këto kushte KAS i konsultuar në vend në zbatim të nenit 129 pika 3, shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, vendos kalimin e kërkesës numër 48, të depozituar nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim. Për shqyrtim dhe po ashtu unë, në cilësinë e relatorit të kësaj kërkesë ankimore duke konstatuar se ka dhe një kërkesë tjetër ankimore të depozituar në lidhje me Qarkun Korçë nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 132, pika 1, të Kodit zgjedhor, propozoj që kjo kërkesë ankimore pra kërkesa ankimore me numër 48 të bashkohet me kërkesën ankimore numër 43 dhe të shqyrtohen bashkarisht në zbatim të këti neni në relatin e anëtarit Elvis Çefa. Kështu që dhe orari i zhvillimit i seancës administrative duke qenë se do të bashkohet do të bëhet njëkohësisht me atë të kërkesës ankimore numër 43. Nesër, me datë 12 Maj 2021, në orën 14:00, faleminderit.

**Vendimi nr. 82**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



**11.05.2021  
Ora 12:23**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Bashkimi i Kërkesës Ankimore nr.51 dhe Kërkesës Ankimore nr.39"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z.L.Braho:** Në zbatim të nenit 132, të Kodit Zgjedhor në lidhje me bashkimin e kërkesave ankimore duke qenë se ka dhe një kërkesë tjetër ankimore në lidhje me Qarkun Tiranë që është më konkretisht Kërkesa Ankimore nr.39 e depozituar nga subjekti zgjedhor Koalicioni PD-AN. Propozoj bashkimin e këtyre dy kërkesave ankimore dhe duke qenë se dhe Kërkesën Ankimore nr.39, jam unë relator, anëtari Ledio Braho dhe në këtë jam po unë relator në qoftë se vendoset bashkimi që pranohet nga anëtarët e KAS-it. Kjo kërkesë do të shqyrtohet bashkarisht me Kërkesën Ankimore nr.39. Seanca në lidhje me këto dy kërkesa ankimore që do të gjykohen bashkarisht do të zhvillohet në datën 12 Maj 2021 në orën 13:00. Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 83**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*

